

KUPONI DHURATË
KUSHTET DHE AFATET E PËRGJITHSHME

1. Kuponi Dhuratë ("Kuponi") është i vlefshëm për blerjen e produkteve që shiten në çdo dyqan fizik dhe online në çdo faqe interneti të Grupit Inditex në Shqipëri: Zara, Pull&Bear, Massimo Dutti, Bershka, Stradivarius dhe Zara Home (në vijim, secili prej tyre veçmas "Dyqani" dhe së bashku "Dyqanet").
2. Kuponi është pronë e emetuesit: "ITX ALBANIA" SHPK, NIPT L32326015U, me seli në Tiranë, Rr. Dervish Hima, ndërtesa Ambasador 3, Kati i 11, Nr. 86, Nr. 87. Mbajtësi i Kuponit është vetëm përdorues dhe ruajtës i tij.
3. Kthimi i çdo Kuponi që nuk është përdorur ende do të pranohet vetëm në Dyqanin ku është blerë, brenda afateve të mëposhtme:
 - 3.1 Kuponët Fizike, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e blerjes, për Kuponët e blerë në dyqane fizike, dhe nga data e email-it të konfirmimit të dërgesës, për Kuponët e blerë online.
 - 3.2 Kuponët Virtualë, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e dërgimit të Kuponit te marrësi i tij i synuar.

Shitja e këtyre formateve të ndryshme të kuponëve do t'i nënshtrohet disponueshmërisë së tyre në Shqipëri.

Për qëllimet e kësaj dispozite, përdorim konsiderohet si përdorimi i kuponit për blerjen e produkteve ashtu edhe rimbushja e tij

Çmimi i paguar për Kuponin do të rimbursohet duke përdorur të njëjtën mënyrë pagese që është përdorur për blerjen e tij. Për këtë rimbursim duhet të paraqitet fatura origjinale ose bileta elektronike dhe, sipas rastit, karta e pagesës dhe dëshmia e pagesës. Kthimi i çdo Kuponi të blerë jashtë vendit ose në ndonjë faqe interneti të një shteti tjetër nuk do të pranohet.

4. Kuponi mund të rimbushet, por çdo bilanc i mbetur në Kupon nuk do të rimbursohet dhe nuk mund të shkëmbehet me para në dorë.
5. Kur është e zbatueshme, çdo rimbursim i çmimit të produkteve të blera me Kupon dhe të kthyerat më pas do të bëhet duke kredituar çmimin e produkteve të kthyerat në bilancin e mbetur të Kuponit. Megjithatë, nëse Kuponi nuk ekziston më në momentin e kthimit të produkteve, çmimi i produkteve të kthyerat do të kreditohet në një Kupon *Voucher*, kushtet e përdorimit të së cilit janë si më poshtë: Kuponat *Voucher* janë të vlefshme për blerjen e çdo produkti që shitet në Dyqane. Bilanci i mbetur në to nuk do të rimbursohet dhe nuk mund të shkëmbehet me para në dorë. Kuponat *Voucher* të humbura, të vjedhura ose të dëmtuara nuk do të zëvendësohen.

Metoda e rimbursimit e parashikuar këtu është një kusht thelbësor. Me blerjen dhe/ose përdorimin e Kuponit, kjo vërteton pranimin tuaj të plotë të këtij kushti.

6. Kuponi nuk ka afat skadence.
7. Kuponi është instrument në posedim të mbajtësit. Mbajtësi i tij është vetëm përgjegjës për përdorimin dhe ruajtjen e Kuponit. Kuponi nuk do të zëvendësohet në rast vjedhjeje,

humbjeje ose dëmtimi. Megjithatë, emetuesi mund ta zëvendësojë Kuponin në rast ndryshimi të formatit të tij.

8. Kuponët e marrë përmes çfarëdo mjeti të paligjshëm, do të jenë të pavlefshëm dhe nuk mund të përdoren për të blerë produkte, e as çmimi i tyre nuk do të rimbursohet.
9. Në rastin e blerjes së një Kuponi Virtual, ne nuk mbajmë përgjegjësi për mosmarrjen ose vonesën në marrjen e Kuponit nga marrësi i tij i synuar për shkaqe jashtë kontrollit tonë, duke përfshirë, ndër të tjera: (i) mangësitë ose ndërprerjet e linjave/sistemeve të telekomunikacionit; (ii) vonesën në transmetimin e informacionit ose të të dhënave, apo humbjen e informacionit ose të të dhënave që mund të ndodhë në ndonjërin nga rrethanat e përmendura në pikën (i) më sipër; (iii) pasaktësinë e të dhënave të marrësit të Kuponit Virtual të dhëna nga blerësi i Kuponit; (iv) pamundësinë e dorëzimit të Kuponit në adresën e email-it të dhënë; ose (v) faktin që email-i i dërguar konsiderohet si *spam* ose email i padëshiruar.
10. Kuponi nuk do të përdoret për qëllime reklamimi ose promovimi të produkteve apo të shërbimeve të tregtuara nga ndonjë palë e tretë, përveç nëse është dhënë pëlqimi paraprak me shkrim nga emetuesi.
11. Blerja dhe/ose përdorimi i Kuponit nënkupton pranimin e plotë të këtyre afateve dhe kushteve, të cilat i janë vënë në dispozicion klientit në momentin e blerjes së Kuponit dhe janë gjithashtu të disponueshme në Dyqane.